	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 1 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		


OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 184 Dt. 28 01 2022
 PRISHTINË-A

Raporti i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të KOSTT-it Viti 2021


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri Pozita	Mimoza Byqmeti Zyrtare për Pajtueshmëri/u.d.Sekretare e Kompanisë	Sabri Musiqi Drejtor i Departamentit për Operim të Sistemit	Kadri Kadriu u.d.Kryeshef Ekzekutiv
Nënshkrimi			
Data	Janar 2022	Janar 2022	Janar 2022



	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 2 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Ndërmarrja	4
2. Programi i Pajtueshmërisë.....	4
3.Pronësia e sistemit të transmetimit	4
4.Kontrolli dhe pronësia e KOSTT si OST	5
5.Pavarësia e Bordit të KOSTT	5
6.Pavarësia financiare e KOSTT	6
7.Përshtatshmëria e burimeve njerëzore.....	8
8.Qasja jodiskriminuese në sistemin e transmetimit (konfidencialiteti i të dhënave)	8
9.Trajnimi.....	8
10.Informacionet e ofruara nga KOSTT për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.	9
11.Detyrat e OST-së.....	9
12.Vonesa ose braktisja e investimeve të planifikuara	11
Projektet e fazës së VII - KfW	12
Projektet e shtyera për shkak të krizës energjetike dhe financiare.....	13
13.Dividenda.....	13
Konkluzion	14

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 3 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Hyrje

Operatori i Sistemit të Transmetimit KOSTT ka hartuar Raportin e Pajtueshmërisë për vitin 2021 në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Direktivës Nr. 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me Rregullat e përbashkëta për Tregjet e Brendshme për Energji Elektrike e datës 13 korrik 2009, dhe nenit 21 të Rregullës për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, Rregulla ZRRE/Nr. 14/2017 (prill 2017), e cila e obligon OST-në që ta hartoj atë dhe ta dorëzoj të njëjtin pranë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për miratim.


Me 15 shkurt 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) ka nxjerr vendimin me nr.V_1107_2019 për miratimin përfundimtar të Certifikimit të KOSTT sh.a. si OST.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ka caktuar znj. Mimoza Byqmeti në detyrën e Zyrtares për Pajtueshmëri (këtu e tutje referuar si Zyrtari për Pajtueshmëri), e miratuar nga Rregullatori me Vendimin V_1186_2019 të datës 14 tetor 2019.

Ky raport është hartuar nga Zyrtari për Pajtueshmëri në bazë të detyrave të cilat rrjedhin nga Programi i Pajtueshmërisë, i miratuar me vendim të Bordit të ZRRE-se nr.V_1203_2019 me datë 27 nëntor 2019.

Rrjedhimisht, pas certifikimit të KOSTT sh.a. si OST prezanton Raportin e tretë të pajtueshmërisë i cili përgatitet nga Zyrtari për Pajtueshmëri dhe bazuar në obligimet të cilat derivojnë nga Programi i Pajtueshmërisë i cekur si më lartë pasqyron gjendjen e pajtueshmërisë e cila është objekt raportimi për periudhën 1 janar-31dhjetor 2021, me qëllim të sigurimit të operimit të pavarur të rrjetit të transmetimit të Kosovës, dhe pajtueshmërinë me vendimin përfundimtar për certifikim, të nxjerrë nga Rregullatori.

Në hartimin e këtij raporti Zyrtari i Pajtueshmërisë është mbështetur me informacionin e nevojshëm nga Departamentet përkatëse të OST-së, sipas funksioneve që kryejnë siç janë: Operatori i Transmetimit, Operatori i Sistemit, Operatori i Tregut, Financat dhe Thesari, Prokurimi, Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve, Çështjet Rregullative dhe Tarifat, Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Përkrahëse.

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Page 4 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

1. Ndërmarrja

Operator Sistemi, Transmetimi dhe Tregu KOSTT sh.a është ndërmarrje publike me 100% të aksioneve shtetërore, e themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KOSTT ka dy Licenca të lëshuara nga ZRrE, Licenca për operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike me numër ZRRE/Li_15/17 si dhe Licenca për operatorin e tregut të energjisë elektrike me numër ZRRE/Li_16/17.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmetimit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV. Përgjegjësi e KOSTT është që në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme të transmetojë energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

KOSTT gjithashtu është përgjegjës për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, si dhe funksioneve të ndërlidhura si janë përshkruar në licencën për operimin e tregut dhe ligjet përkatëse.


2. Programi i Pajtuëshmërisë

Programi i Pajtuëshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit i miratuar nga Bordi i ZRRE-së me vendimin nr.V_1203_2019 me datë 27 nëntor 2019, paraqet një program i cili përcakton masat të cilat duhen të ndërmerren me qëllim të parandalimit të çfarëdo trajtimi diskriminues, aplikimin e masave të nevojshme për të monitoruar pajtuëshmërinë e vazhdueshme të operatorit të sistemit të transmetimit me programin e pajtuëshmërisë.

3. Pronësia e sistemit të transmetimit

KOSTT ka në pronësi dhe operon sistemin e transmetimit në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe interkonektorët me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, deri te pikat interkonektuese.

KOSTT ka në pronësi asetet e mëposhtme që janë pjesë e interkoneksionit midis sistemit të transmetimit të Kosovës dhe sistemeve të transmetimit të vendeve fqinje:

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 5 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

- a. Linja 400kV, 85.5 km SS Kosova B- NS Komani deri në kufi me Shqipërinë
- b. Linja 400kV, nr. 407, 40.049 km NS Kosova B-SS Nish deri në kufi me Serbinë
- c. Linja 400kV, nr. 420/2, 30.51 km NS Ferizaj- NS Shkup 5 deri në kufi me Maqedoninë e Veriut
- d. Linja 400kV, nr. 437/2, 28.709 km NS Peja - NS Ribarevine deri në kufi me Malin e Zi
- e. Linja 220kV, nr. 2303, 45.05 km NS Prizren-2 NS Fierzë deri në kufi me Shqipërinë
- f. Linja 220kV, nr. 205/2, 14.648 km NS Besiana-NS Krushevc deri në kufi me Serbinë
- g. Linja 110kV, nr. 1140, 10.81 km NS Berivojcë -NS Bujanovc deri në kufi me Serbinë
- h. Linja 110kV, nr. 155, 18.78 km NS Vallaç-NS N. Pazar deri në kufi me Serbinë

4. Kontrolli dhe pronësia e KOSTT si OST

KOSTT sh.a. është ndërmarrje publike ku:


- a) Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni i vetëm që kontrollon OST-në me kompetenca ekskluzive për të ushtruar të drejtat e aksionarit, të emëroj dhe shkarkoj Bordin e Drejtorëve duke përjashtuar Kryeshefin Ekzekutiv dhe caktimin e pagesës (kompensimit) të Bordit të Drejtorëve. Komisioni i Auditimit të OST-së po ashtu emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- b) Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ushtron kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në asnjë ndërmarrje tjetër aktive në tregun e raportueshëm. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka të drejta mbi çfarëdo ndërmarrje tjetër në tregun e raportueshëm (KEK sh.a. dhe Ibër Lepenci sh.a.) as në personin që ushtron të drejtat e aksionarit në lidhje me këto ndërmarrje.

5.Pavarësia e Bordit të KOSTT

Mungesa e Bord-it të Drejtorëve në KOSTT deri me 10 korrik 2020, ka pasur për pasojë pengesa në proceset zhvillimore të KOSTT, e në veçanti sa i përket inicimit dhe implementimit të projekteve kapitale për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të cilat kanë reflektuar edhe në vitin 2021.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT gjatë periudhës raportuese ka qenë në këtë përbërje:

- z. Jeton Mehmeti (Kryesues)
- z. Arben Dodaj, Anëtarë
- z. Nebih Zariqi, Anëtarë
- znj. Ajrina Gashi Hamdiu

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Page 6 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

znj. Xhyldane Kiçmari

Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin Nr.08-V-063 të datës 12.08.2021 ka shkarkuar znj.Xhyldane Kiçmari nga pozita e anëtares së Bordit të NP KOSTT Sh.a.

Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2021 nuk ka emëruar Komisionin e Auditimit të KOSTT.

Në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike Kryeshefi Ekzekutiv sipas detyrës është anëtarë i Bordit të Drejtorëve. Gjatë periudhës raportuese Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT deri me datën 16 shtator 2021 ka qenë z. Mustafë Hasani, ndërsa nga data 16 shtator 2021 ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT është z. Kadri Kadriu.

6. Pavarësia financiare e KOSTT


KOSTT ka pavarësinë financiare për të miratuar shpenzimet e nevojshme dhe ka demonstruar një historik të investimeve kapitale për sistemin e operimeve, mirëmbajtjes dhe zhvillimit. KOSTT ka qasje në institucionet financiare ndërkombëtare për të financuar investimet kapitale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit në dy mënyra:

- a. përmes marrëveshjeve trepalëshe të huas ndërkombëtare me institucionet financiare ndërkombëtare; dhe
- b. përmes marrëveshjeve dypalëshe me bankat tregtare

KOSTT nuk merr ndonjë mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës për financimin e aktiviteteteve të veta statutore.

Më fillimin e implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E e cila ka rezultuar edhe me operimin e KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri (Blloku AK) në kuadër të Evropës Kontinentale, Kosova është njohur si zonë tregtare, ku balancimi i sistemit do të jetë përgjegjësi e plotë e KOSTT, që nënkupton mbulimin e të gjitha devijimeve nga sistemi i Kosovës. KOSTT ka filluar alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongjestionëve, që nënkupton mbledhjen e të hyrave nga tregtimet ndërkufitare. Pra, kjo marrëveshje sjellë përfitime por edhe në të njëjtën kohë e ngarkon me përgjegjësi KOSTT-in në lidhje me operimin e sigurt të sistemit interkonektiv.

Në anën tjetër, me hapjen e tregut të energjisë elektrike në prill të vitit 2017, ZRrE përgjegjësinë për furnizimin e komunave me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës nga KESCO e ka bartë në KOSTT, duke e emëruar si humbje të sistemit, dhe në bazë të Vendimit V_907_2017, të datës 13 prill 2017, aprovon të hyra KOSTT-it për mbulimin e

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Page 7 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

humbjeve në sistem (konsumi i pjesës veriore të Kosovës) për vitin tarifor 01.04.2017 - 31.03.2018.

Duhet të theksohet se KOSTT në bazë të Ligjit për Energjinë Elektrike nuk mund të kryejë funksione të furnizimit (faturimit dhe inkasimit të konsumit), dhe se ky detyrim i vendosur nga ZRrE nuk është përgjegjësi formale e KOSTT në bazë të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Më datë 30 nëntor 2017, KOSTT ka pranuar nga ZRrE shkresën “Njoftim për zbatimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 1373/2017 i datës 11.09.2017 të vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. Nr. 451/2017 i datës 20 tetor 2017”, përmes të cilës ZRrE i pezullon KOSTT-it të hyrat për mbulimin humbjeve në sistem (konsumi i pjesës veriore të Kosovës), të nxjerrë në bazë të Raportit të Avokatit të Popullit.


Në këtë kontekst, pra në pamundësi ligjore dhe financiare, KOSTT ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të ndaj mjete për mbulimin e konsumit të pjesës veriore të Kosovës, derisa çështja a furnizimit të pjesës veriore të Kosovës të adresohet në mënyrë të rregullt. Kjo kërkesë është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës përmes Ligjit për Buxhet, ku janë ndarë €10 milion euro për këtë qëllim.

Më pas, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Rekomandimet Nr.08-R-01 në seancën plenare të datës 06.05.2021 me të cilat ka autorizuar NP KOSTT të mbuloj devijimet e energjisë elektrike në katër komunitat e vendit: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, sipas zgjidhjes së prezantuar dhe miratuar në komisionin funksional duke shfrytëzuar tëhyrat nga buxhati vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm.

Rrjedhimisht mbulimi i shpenzimeve të humbjeve të energjisë elektrike për pjesën vijuese të vitit 2021 është bërë konform rekomandimeve të cituara si më lartë.

Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se si pasojë e krizës energjetike rajonale është afektuar edhe sektori i energjisë në Kosovë duke përfshirë edhe KOSTT-in ku në pamundësi të inkasimit të të hyrave nga palët, i është vështirësuar likuiditeti Kompanisë. Rrjedhimisht KOSTT mbetet i angazhuar sistematikisht duke mbajtur kontakte ditore me palët e involvuara me qëllim të inkasimit të këtyre mjeteve.

OST mirëmban llogari të ndara sipas kërkesave rregullative për aktivitetet e ndryshme të licencuara.

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Faqe 8 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

7. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore


KOSTT sh.a. ka stafin e nevojshëm për kryerje të plotë dhe në mënyrë efektive të të gjitha obligimeve në kuptim edhe të një kompanie të themeluar sipas Ligjit për Shoqëri Aksionare si dhe në Ligjin e Punës. Në bazë të Direktivës Nr. 2009/72 / EC, neni 9 (1) (a) OST - KOSTT duhet të jetë në gjendje "të veprojë si Operator i Sistemit të Transmetimit" siç përcaktohet në nenin 2 pika 4 e Direktivës, dhe duhet të ketë " burime njerëzore, teknike dhe financiare " në mënyrë që të kryej funksionet e OST-së. Parime dhe kërkesa të tilla sanksionohen edhe me nenin 16.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili përcakton se "Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ketë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për funksionimin e sigurt, të besueshëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit".

8. Qasja jodiskriminuese në sistemin e transmetimit (konfidencialiteti i të dhënave)

KOSTT në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike ka zhvilluar Kodin e Rrjetit i cili është miratuar nga ZRrE në atë mënyrë që të sigurojë mos diskriminim dhe transparencë në sigurimin e qasjes së palëve të treta në sistemin e transmisionit. KOSTT gjithashtu zbaton Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin Transmetues, dhe një varg procedurash të ndërlydhura të cilat ofrojnë qasje transparente dhe jo diskriminuese për palët të cilat kërkojnë të kyçin kapacitetet e veta në rrjetin transmetues të KOSTT.

9. Trajnimi

KOSTT është në vazhdimësi të përpjekjeve për të sensibilizuar stafin sa i përket çështjes së pajtuëshmërisë dhe njëkohësisht identifikimit të nevojave për përfshirjen e stafit të nevojshëm në trajnim. KOSTT është i vetëdijshëm se njohuritë e stafit rreth pajtuëshmërisë me kërkesat e shturjes pronësore janë të një rëndësie të veçantë për procesin e vlerësimit vjetor dhe sigurimin e pajtuëshmërisë, andaj edhe ndërmarrja e masave respektivisht organizimi i trajnimeve në këtë fushë është më se i nevojshëm. Gjithashtu edhe në këtë periudhë kohore të raportimit gjendja e krijuar si pasojë e pandemisë me COVID-19 ka paraqitur pengesë për zhvillimin e shumë aktiviteteve në përgjithësi e në veçanti ndjekjes së trajnimeve edhe sa i përket fushës së pajtuëshmërisë. Varësisht nga rrethanat të cilat do të mbizotërojnë në këtë aspekt planifikimi dhe organizimi i trajnimeve lidhur me pajtuëshmërinë mbetet në përgjegjësi të sektorit përkatës përshtatshëmrisht me nevojat e identifikuar për stafin.

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Faqe 9 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

10. Informacionet e ofruara nga KOSTT për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.

Nga KOSTT, sipas legjislacionit të Kosovës, kërkohet që të bëjë disa parashtrës/raportime rutimore, vjetore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për qëllime informative dhe në rrethana të caktuara të kufizuara pranë Ministrisë së Financave. Që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Energji Elektrike dhe certifikimit, nga KOSTT nuk është kërkuar që të paraqet ndonjë informacion në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit ose Ministrinë e Financave.

KOSTT mban kontakte dhe takime të rregullta me akterët e sektorit të energjisë elektrike, kështu që janë mbajtur një seri takimesh që synojnë koordinimin e aktiviteteve në nivel sektorial dhe lidhur me zbatimin e Strategjisë së Energjisë si dhe lidhur me tejkalimin e krizës me energji elektrike në vend, me ME, ZRRE, KEDS, KESCO dhe palë të tjera.


KOSTT ka mbajtur kontakte të rregullta me Qeverinë dhe akterët e tjerë me qëllim të informimit dhe koordinimit të aktiviteteve, e në veçanti sa i përket implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E.

11. Detyrat e OST-së

Ligjet e Kosovës për energjinë, dhe kryesisht Neni 16 i Ligjit për Energjinë Elektrike, kanë të transpozuar, plotësisht dispozitat e Direktivës 2009/72/KE në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e OST-së. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit dhe Transmetimit (OST) është përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes, dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Po ashtu, KOSTT është përgjegjës për ndërlidhjen e rrjetit me rrjetet e tjera si dhe për sigurimin afatgjatë të aftësisë së sistemit për të përballuar kërkesat e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka dhënë KOSTT-it sh.a, licencën si Operator i Sistemit të Transmetimit, licencë kjo e cila ka hyrë në fuqi më 4 tetor 2006, numër reference ZRRE/Li_15/06 për operimin e sistemit të transmetimit. Në të njëjtën kohë, ZRRE lëshoi një licencë të ndarë për KOSTT Sh.A. për operimin e tregut me numër reference ZRRE/Li_16/06, të cilat u modifikua me vendimin e ZRRE-së të datës 18 korrik 2012 referenca V_434_2012. Po ashtu, licenca e OST-së u modifikua nga ZRRE në vitin 2012, me numrin e referencës së modifikuar ZRRE/Li_15/12 që hyri në fuqi më 18 korrik 2012. Licencat aktuale të KOSTT janë ndryshuar në vitin 2017 në zbatim të kërkesave ligjore nga ligjet e energjisë të miratuara në vitin 2016.

Pra, aktualisht KOSTT është mbajtës i dy Licencave të lëshuara nga ZRRE, Licenca për operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike me numër ZRRE/Li_15/17 si dhe Licenca për operatorin e tregut të energjisë elektrike me numër ZRRE/Li_16/17.

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Faqe 10 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Operatori i Sistemit të Transmetimit menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës si dhe është përgjegjës për transmetimin e energjisë elektrike në rrjetet kryesore të tensionit të lartë.

Operatori i Sistemit dhe Transmetimit të Kosovës :


- Vepron në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Kodit të Matjes dhe Kodit të Shpërndarjes
- Siguron qasje jodiskriminuese për shfrytëzuesit dhe u siguron atyre informata të nevojshme për një qasje efikase në sistem
- Përcakton të tilla tarifa dhe pagesa për kyçje dhe shfrytëzim të sistemit që të nxisin konkurrencën në sektorin e energjisë si dhe të lehtësojnë hyrjen e subjekteve të reja në treg.

Me operacionalizimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E -janë shënuar përfitimet si në vijim:

- Inkasimi i të hyrave nga shfrytëzimi i rrjetit transmetues interkonektiv apo alokimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i kongjestioneve, që kap vlerën në mesatare vjetore 3.0 – 6.0 Mil EUR dhe nga transiti varet nga niveli i importit dhe tranzitit dhe sillet prej - 0.2 deri në 0.5 Mil EUR;
- Lëshimi në operim të plotë i linjës interkonektive 400 kV, Kosovë – Shqipëri;
- Implementimi i plotë i Marrëveshjes së Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 26.11.2019;
- Ndarja e rezervave të sistemit në kuadër të bllokut KOSTT-OST si dhe
- Pjesëmarrja me aksione në Bursën Shqiptare të energjisë elektrike (ALPEX)

Gjithashtu është shënuar progres edhe në funksionalizimin e themelimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) ku është filluar me konsolidimin e stafit.

Fundi i vitit 2020 ishte përmbyllur me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E ku ka filluar operimi i pavarur i KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë. Linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri e njohur si “Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri” edhe komercialisht ka filluar në operim. Me fillimin e operimit si zonë e pavarur rregulluese, KOSTT bënë alokimin e kapaciteteve interkonektive të transmetimit me vendet fqinje, si OST (Shqipëri), MEPSO (Maqedonia e Veriut), dhe CGES (Mali i Zi). Alokimi i kapaciteteve kryhet nga SEE CAO (Zyra për Alokimin e Kapaciteteve) me seli në Mal të Zi. Në anën tjetër, EMS (Serbi) ka

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Faqe 11 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

refuzuar bashkëpunimin me KOSTT lidhur me përcaktimin e NTC që është parakusht për alokimin e kapaciteteve në kufirin Serbi (EMS) – Kosovë (KOSTT), dhe rrjedhimisht në këtë kufi nuk ka transaksione komerciale të energjisë.

12. Vonesa e investimeve të planifikuara

Sa i përket gjendjes së investimeve, është konstatuar se Plani Investiv 2018-2022, ka nevojë për plotësime me qëllim të përmbushjes së kërkesave për sigurinë e furnizimit, sigurinë kibernetike, kualitetin e furnizimit dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Arsyeshmëria për këto ndryshime është paraqitur në vijim.

12.1 Arsyeshmëria për shtyerjen e afatit të realizimit të projekteve sipas Planit Investiv 2018-2022

12.2 Realizimi i projektit me vonesa për shkak të vonesave gjatë procesit për marrjen e lejeve, realizimit të shpronësimit dhe servitutit si dhe pengesa nga pronarët e tokave dhe vonesa e përgjigjeve nga Ministria e Infrastrukturës.

- a. Projekti (ID/004) Linja Ajrore/Kablllore 110 kV NS Fushë Kosova (projekti ka përfunduar në vitin 2021)

Ky projekt është në kuadër të projekteve të financuara nga BERZH (EBRD), i cili ka pasur vonesa në marrjen e lejeve për ndërtim, shpronësim dhe servitut, prandaj projekti i paraparë për përfundim në vitin 2019 është shtyrë deri në Q2 2021. Vlera e planifikuar e projektit 1,4 Mil €. Po ashtu projekti ka pasur vonesa për shkak të pengesave dhe ankesave nga pronarët e tokave në komunën e Graçanicës, dhe të Fushë Kosovës.


Po ashtu projekti është vonuar edhe si rezultat i problemeve teknike nga paraqitja e gypave kryesor të ujësjellësit KRU Prishtina, në trasen e njëjtë me atë të kabllit, për të cilën paraprakisht ka pasur pëlqim nga KRU. Zgjidhja teknike ka kërkuar aprovimin edhe nga Ministria e Infrastrukturës që ka shkaktuar vonesa në projekt.

12.3 Grupi i projekteve që janë bartur për realizim në vitet 2020-2023 dhe janë nënshkruar kontrata janë projektet si në vijim:

- a. Projekti (ID/049): NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV
- b. Projekti (ID/004): NS Fushë Kosova GIS 110/35/10(20)kV

12.4 Grupi i projekteve që nuk kanë filluar me realizim për shkaqe të ndryshme dhe që realizimi bartet në vitet tjera të periudhës 2022-2024 janë:

- c. Projekti (ID/011): NS Malishevë AIS 220/35/10(20)kV
- d. Projekti (ID/029) “Ndërimi i Sistemit ekzistues SCADA/EMS ne QND dhe QNDE”.

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Faqe 12 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

Për projektet e lartshënuara janë përgatitur Termet e References dhe specifikimet teknike të cilat janë dërguar në prokurim për procesim tenderik. Projekti i NS Malishevë AIS 220/35/10(20)kV është në procedurë ankimore në OSHP, ndërsa projekti "Ndërrimi i Sistemit ekzistues SCADA/EMS ne QND dhe QNDE" është në pritje. Këto projekte janë në proces të ankesës në OSHP i cili rrjedhimisht ndikon edhe në shtyrjen e afatit të realizimit të projekteve.

Sqarim :


Rreth realizimit të shpenzimeve duhet të merret për bazë gjendja faktike se:

- a. KOSTT nuk gjendet në situatë të paaftësisë për të paguar – insolvencë
- b. KOSTT nuk gjendet në gjendje bankroti - qoftë të shpallur apo pa shpallur, apo procesi të likuidimit - qoftë vullnetar apo të dhunshëm
- c. Menaxhmenti i KOSTT ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë dhe në afat ligjor Planin e Biznesit dhe Buxhetin për vitin 2021
- d. KOSTT është ende në pritje të përgjigjes nga Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP, ku në mungesë të Bordit është pamundësuar adresimi i implementimit të projekteve për më tepër se një vit.

12.5 Projektet e fazës së VII - KfW

Sipas planit investiv ky grup i projekteve është planifikuar të financohet me kredi nga KfW ku përmes shërbimeve konsulent është paraprë përgatitja e specifikimit teknik në vitin 2019 ndërsa realizimi gjatë vitit 2020-2022. Meqenëse marrëveshja për kredi me KfW për arsye të ndryshme nuk është nënshkruar me kohë edhe dinamika si dhe shuma e realizimit të projekteve ka pësuar ndryshime, dhe si të tilla janë inkorporuar në një fazë të vetme pra në fazën VII. Për shkak të mos finalizimit të marrëveshjes për kredi projekti shtyhet për vitet e ardhshme ashtu që realizimi planifikohet të jetë në periudhën prej vitit 2022- 2025.

"Marrëveshja për kredi ndërmjet KOSTT dhe KfW për Fazën VI-VII është iniciuar qysh në vitin 2013, ndërsa fillimi formal i nismës për lidhjen e marrëveshjes për kredi është miratuar nga Qeveria e Kosovës me 08.09.2016 me Vendimin Nr. 03/108, ndërsa negociatat formale ndërmjet KOSTT, Ministrisë së Financave dhe KfW ishin mbajtur me 13 dhe 14 nëntor 2017. Që nga Dhjetori 2017 për shkak të implikimeve politike në Kosovë si dhe obstrukcioneve nga Serbia për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT, vazhdimi i mëtejme i procedurave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kredi për Fazën VI-VII ishte pezulluar me kërkesë të palës gjermane/KfW, dhe atë deri në qartësimin e pozicionit të KOSTT për operimin e pavarur dhe futjen në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. "

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Faqe 13 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Me hyrjen në operim të linjës në fund të vitit 2021 në nëntor-dhjetor janë zhvilluar edhe negociatat rreth kredisë për fazën e VII, ku finalizimi i kësaj marrëveshje është në proces, sidoqoftë realizimi dhe zhvillimi i kredisë është i ndikuar edhe nga situata politike. Vlera e planifikuar e projekteve 25,5Mil € (pa shpronësim dhe servitut).

12.6 Projektet e shtyera për shkak të krizës energjetike dhe financiare

Për shkak të krizës energjetike dhe problemeve me likuiditet të kompanisë si rezultat i vonesave të pagesave të obligimeve nga KESCO dhe KEDS dhe mbulimit të kostove për furnizimin e konsumit në pjesën veriore të Kosovës disa nga projektet janë shtyrë në procesin e inicimit të prokurimit si në vijim:

- Instalimi i SHUNT Reaktorit Variabil nw NS. 400/110 kV Ferizaj 2;
- Projekti i SCADA-s
- Projekti i Telekomit, ETJ.


13.Dividenda

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.08-051 të datës 28.07.2021 në seancën plenare të mbajtur me 28 korrik për miratimin e Ligjit nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Ligjin nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, neni 25A, paragrafi 1, i cili autorizon Qeverinë të kërkojë shpërndarjen e dividendës nga KOSTT në përputhje me shumën e parashikimeve në tabelën 1 të këtij ligji.

Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.13/31 të datës 25.08.2021, sipas të cilit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon shpërndarjen e dividendës nga KOSTT sh.a. në përputhje me autorizimin nga neni 24 A dhe tabelën 1, të Ligjit nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 në vlerë prej 20.000.000€ nga fitimet e shpërndara sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me të cilën kërkohet deklarimi dhe shpërndarja e dividendës nga Ndërmarrja publike KOSTT sh.a. në shumën prej 20.000.000€, mjete këto që duhet të derdhen në llogarinë e vetme të Thesarit të Kosovës.

	Raporti i Pajtuëshmërisë së OST	
		<i>Faqe 14 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST</i>		

Bordi i Drejtorëve me Vendimin 210927/II-2 ka aprovuar shpërndarjen e dividendës nga KOSTT në shumë prej 20.000.000€ dhe ka autorizuar shërbimet profesionale që këto mjete të transferohen në llogarinë e Thesarit të Republikës së Kosovës.

Më pas bazuar në kërkesën e KOSTT sh.a. për kthimin e dividendës Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.23/50 ka:

1. Shfuqizuar pikën 1.1. të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.13/31 të datës 25.08.2021.
2. Obliguar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes Thesarit, të kthejë të plotë shumën prej 20.000.000€ në llogari të KOSTT sh.a. nga bilanci bankar i shfrytëzueshëm, përkatësisht si regjistrim i kundërt i veprimit të pranimit të fondeve në kodin e dedikuar kontabël në SIMFK për regjistrim të të hyrës nga dividenda.
3. Bordit të Ndërmarrjes Publike KOSTT sh.a. i sygjerohet të rishikojë çështjen e deklarimit dhe pagesës së dividendës pas përmbylljes së auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2021.


Konkluzion

Raporti i Pajtuëshmërisë për vitin 2021 përshkruan gjendjen e pajtuëshmërisë në OST KOSTT bazuar në informacionet e siguruara përmes bashkëpunimit me strukturat përkatëse të OST-së.

Zyrtari i Pajtuëshmërisë konsideron që trajnimi i stafit lidhur me çështjet të cilat ndërlidhen me shthurjen pronësore do të kontribuonte në sensibilizimin e stafit për të raportuar çdo informatë e cila potencialisht do të përbënte cenim të pajtuëshmërisë. Raportimi i informatave të plota të sakta dhe në kohë reale që vënë në mëdyshje pajtuëshmërinë qëndron në faktin se mundësohet zbatimi më efikas i çdo pike të Programit të Pajtuëshmërisë.

Megjithatë, publikimet e Raporteve të miratuara të Pajtuëshmërisë për vitet paraprake në faqen elektronike zyrtare të KOSTT konsiderohen se kanë ndikim pozitiv. Kjo formë e informimit përbënë një hap tutje drejt shpërndarjes së informacionit lidhur me mundësinë dhe rëndësinë e komunikimit në mes të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë dhe stafit të KOSTT lidhur me raportimin e çfarëdo të dhëne e cila në një formë apo tjetër do të mund të konsiderohej se do të cenonte pajtuëshmërinë e OST të KOSTT.

Bazuar në vlerësimin e kryer në lidhje me pajtuëshmërinë mund të konstatohet se KOSTT që nga certifikimi i saj si OST me datë 15 shkurt 2019 ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përmbushjen e obligimeve të marra me qëllim të sigurimit të shthurjes pronësore.

	Raporti i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Faqe 15 nga 15</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

Gjithashtu konsiderohet se po shënohet progres edhe sa i përket sensibilizimit lidhur me rëndësinë e sigurimit të pavarësisë së OST-së, sigurimit të transparencës, evitimit të konfliktit të interesit, trajtimit të barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit, qasjes jo diskriminuese për të gjithë përdoruesit në harmoni me kornizën ligjore e cila rregullon sektorin e energjisë. Prandaj, përkushtimi dhe bashkëpunimi i strukturave të KOSTT lidhur me sigurimin e pajtueshmërisë në harmoni me Programin e Pajtueshmërisë mund të konstatohet se është i kënaqshëm.